

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM PËR TRANSFERIM DHE PROGRAM I DYTË STUDIMI PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMIT

VITI AKADEMIK 2026-2027

TRANSFERIM DHE PROGRAM I DYTË

PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve, paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:

- a) Formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 3);
- b) Deklaraten sipas shtojcës 1
- c) **planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;**
- d **vërtetim të listës së notave** dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur; studentët që transferojnë studimet e tyre nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe **syllabuset përkatëse** dhe listën e notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, duhet t'i dorëzojnë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin;
- e) **kopje e njësuar me origjinalin të dëftesës së pjekurisë** të shkollës së mesme (kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011).
- e) **fotokopje të dokumentit të identifikimit**
- f) **dy fotografi personale;**
- g) **kopje të mandatpagesës.**

Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

- a) emrin, atësinë, mbiemrin;
- b) datëlindjen;
- c). vendlindjen;
- d). shtetësinë;
- e). numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;
- f). emrin e shkollës së mesme/IAL-së ku ka kryer shkollën//studimet përpara ndjekjes së këtij programi studimi;
- g) ID-në e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë¹;

¹ Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006.

- h). numrin personal të identitetit;
- i)). datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;
- j). emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;
- k). ciklin dhe formën e studimit;
- l) datën e ndërprerjes së studimeve.

Kandidati që aplikon për **program të dytë studimi** (FAKULTET I DYTË)paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

- a) kërkesa drejtuar IAL—së për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës 6);
- b) kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës;
- c) vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);
- d) fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme (kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011). Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP përkatëse, ose listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
- e) fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
- f) dy fotografi personale.

Kandidatet fitues me diplome të huaj ne keto programe studimi i nenshtrohen procedurave te aplikimit dhe regjistrimit si te gjithe kandidatet e tjere, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

Formular aplikimi

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____,
Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit (vendosni një rreth):

- ☐ me karakter profesional 2 – vjeçar
- ☐ ciklit të parë “Bachelor”
- ☐ integruar të ciklit të dytë
- ☐ ciklit të dytë “Master profesional”
- ☐ ciklit të dytë “Master i shkencave” / “Master i arteve”
- ☐ ciklit të tretë “Master ekzekutiv”

në _____, në IAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. Për program të dytë studimi

B. Për transferim studimesh

1. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në ciklin përkatës të studimit.

2. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

3. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

4. Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t’u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër i kandidatit

Emër Mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin

Shtojca nr. 1

Deklaratë

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre.

Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur me këtë udhëzim si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër i i kandidatit

Emër Atësi i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma

Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____ . 2026

Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit: Kategoria, Program i dytë studimi dhe transferime. Viti akademik 2026-2027

<i>RefeFenca në Udhëzim</i>	<i>Afatet e përfundimit dhe data e realizimit</i>
Aplikim	01.09.2026 — 12.09.2026
Shpallja e listave të kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi.	17.09.2026
Shqyrtimi i aplikimeve, vlerësim i dosjeve nga komisioni.	23.09.2026
Publikimi i listave me renditjen e kandidatëve	24.09.2026
Shpallja e listave përfundimtare me renditjen e kandidatëve	26.09.2026
Regjistrimi i kandidatit	06.10.2026 — 10.10.2026
Plotësimi i kuotave të mbetura bosh, sipas kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe.	17.10.2026